

## Kthimi i bukur amerikan i znj.Topalli

[Gazeta Shqiptare, 5.3.2006]

Zonja Topalli u prit shkëlqyeshëm në SHBA: lajme të mira po depërtojnë censurën e kryeministrit tonë xheloz. Senatorë e senatore, zyrtarë të lartë të shtetit më të madh të botës, të gjithë po gjejnë kohë të presin “kryetaren” e vendit “më të vogël”.

Natyrisht, pas kësaj vizite “të suksesshme” në Amerikë, znj. Topalli, duhet të ketë marrë leksionet përkatëse për demokracinë. Ky është peshqeshi më i madh që mund të sjellë në Shqipërinë tonë aktuale, aq në nevojë për një çikë demokraci. Do të ishte një qëndrim që do ta zbukuronte shumë këtë zonjë, nëse me të arritur në Kuvend, do të deklaronte sa vijon:

“Të nderueme zoja e zotni, une kerkoj qi Kuvendi të votojë me votim taman të mshehtë, pra me kuti e me letra, tuj fillue prej meje të parës: të votohet edhe një herë tamanshe për mue, e mbas meje për kedo qi asht nieri me dy kambë, e nuk asht send. Ju falemnders”

Do të ishte një hapje fatlume e Kuvendit shqiptar. Jemi të sigurtë, se votimi do të dilte me së paku 100 vota për zonjën Topalli. Por ajo që do të fitonte, nuk është vetëm ajo personalisht, por do të fitonte demokracia shqiptare.

Po a do të fitonte vetë personalisht znj. Topalli, nga një debutim i tillë?

Varet se kush e sheh. Për ne, për më shumë se gjysmën e shqiptarëve, do të fitonte shumë pikë kjo zonjë e re. Por, për ata që po sulmojnë në kor votën e fshetë, ata kopistët që u doli boja menjëherë sa zunë pozicione vipash, si dhe për fantazmat e errëta të inkuzicionit enverist 62 vjeçar, që po arrijnë nga “emigracioni disa vjeçar”, për këta, ajo do të humbiste personalisht. Kryearmiku i një zonje demokrate, do të ishte kryeministri aktual, e para, sepse ai është vënë në krye të fushatës kundër votës së lirë, e dyta, sepse ai nuk duron konkurrencë politike reale brenda partisë së vet: e znj. Topalli, si konkurente, është shumë e rrezikshme për të.

Ajo, për Amerikën, është jokomunistja, ajo që vjen nga rrethe të goditura rëndë nga komunizmi. Por jo vetëm rrethi nga e ka orogjinën, por, ç’është më e rëndësishmja, ajo vetë jo vetëm që nuk ka qenë “sekretare e PPSH”-së, dhe as anëtare e partisë komuniste, por ka qenë vetë e shtypur: është produkt intelektual i pas 1990-tës. Ajo, pati guximin të mos pranojë si kryeprokuror z. Sollaku, kur atë po e propozonte z. Berisha, kryetari i saj: ajo tha se nuk jam dakord për të kaluarën e tij si hetues i sigurimit komunist në Shkodër, pa e “çarë kokën”, se ai vinte nga një karrierë e sapo përfunduar si këshilltari juridik i presidentit të Shqipërisë, pra i vetë z. Berisha. Me një fjalë, ajo është antiteza e “90% të kolegëve të saj VIP të PD-së aktuale” të maxhorancës së sajuar të sotme, të cilët ose kanë qenë vetë komunistë, bile të niveleve të larta, ose vijnë nga rrethe të tilla. Është e natyrshme, që me këtë CV (biografi), znj. Topalli të pritej me një ngrohtësi të veçantë në Amerikë, nga shteti që shkatërroi komunizmin. Natyrisht që amerikanët e dinë se në Shqipëri, zonja Topalli la mbrapa një Kuvend në zjarr, një zjarr që formalisht lidhet me emrin e saj, por që dihet se kush e ka nderur. Si çdo njeri, edhe zonja Topalli, ka gabimet e saj, ka anët e errëta të karrierës së saj—e kush nuk i ka! Sot ndalua vetëm tek “jo të errëtat”.

E vetmja gjë që mund ta pengojë zonjën Topalli, të bëjë debutin e bukur amerikan, të rreshtohet në mbrojtje të votës së lirë, është frika nga goditja e paburrëri e kryeministrit aktual. Ajo e di se sa i papërmbajtshëm është ai kur sheh rrezikun e konkurrencës politike. Do të ndërsente

kundër saj të gjithë “enveristët dhe analistët mediatikë të konvertuar” (ata që thuhet se po i rikaton me dosjet e tyre të korrupsionit, si ndërtesa pa leje, tatime të papaguara etj.); do të ndërsente kundër saj edhe atë pjesë deputetësh që janë të bindur verbërisht ndaj tij, si butonat e një kompjuteri, meqë pa të janë një hiç, Vërtetë që kryetares do t’i duhej të maste forcat mirë.

Le të shpresojmë se Amerika e ka arritur zbukurimin e kryetares.

Bashkim Kopliku

Durrës, më 4.3.2006